Procesverbal 1/2022

I mbajtur në mbledhjen e I-rë të Komitetit për Komunitete, në kryesimin e z.Xhavit Zariqi Kryesues i KK-se dhe KPF-se me datë 21.01.2022. Në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete përveç emrit rezervë te LVV-se.

Rendi i ditës:

1. **Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhje;**
2. **Miratimi i rendit të ditës;**
3. **Kryesuesi i KK-së z. Xhavit Zariqi elaboron detyrat dhe përgjegjësit e Komitetit për Komunitete;**
4. **Zgjedhja e Kryesuesit dhe zv.Kryesuesit për Komitetin për Komunitete dhe**
5. **Të ndryshme.**

Pika 1

z. Xhavit Zariqi Kryesues i KK-se dhe KPF-se – Përshëndeti të gjithë anëtarët e KK dhe shtoi se janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komitetit, përveç emrit rezervë të LVV-se dhe kemi kuorum për ta vazhduar mbledhjen.

Pika 2

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 3

Kryesuesi i KK-së z. Xhavit Zariqi - Elaboron detyrat dhe përgjegjësit e Komitetit për Komunitete, në theks të veçantë duke i'u shërbyer Komitetit dhe ja jep fjalën z. Hajriz Hazirit .

z. Hajriz Haziri - Merr fjalën dhe propozon për Kryesues të Komitetit për Komunitete z. Osman Eminin, me hedhjen në votim zgjedhet z. Osman Emini Kryesues i Komitetit për Komunitete, kurse për zv. Kryesuese të komitetit për Komunitete zgjedhet znj. Flora Abdullahu.

z. Osman Emini Kryesues i Komitetit për Komunitete - Diskuton per mbajtjen e mbledhjeve të ketij Komiteti, ku do të mbahen takimet e ardhshme dhe ku duhet me dërguar materialin.

Kryesuesi i KK-së z. Xhavit Zariqi – Ofroi mbështetje z. Osmanit dhe se në mbledhjen e ardhëshme do t'i ofrojmë informacione të detajuara për këtë çështje.

Në ora 11.30h përfundon mbledhja e Komitetit për komunitete.

Procesmbajësi

Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i KK dhe KPF-së

Xhavit Zariqi